

	Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo
	Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing	
02	No.Nr. 204-20
25.09.2020	



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës  
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Referenca : 626-20-026-521

Në bazë të paragrafit 6 të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe në bazë të Rregullave për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave neni 4 pikë b dhe nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1. bie këtë:

## V E N D I M

I  
Refuzohet si e pabazuar kërkesa për Rishqyrtim e Operatorit Ekonomik –“Al Group” SHPK - PRISHTINË e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 24.09.2020 për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-20-5348-5-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-20-026-521 me titull: “NDËRTIMI I ANEKSIT TË SHKOLLËS FILLORE NË MAMUSHË-FAZA E PARË NDËRTIMI I VRAZHDËT”

II  
*Anulohet pezullimi i aktivitetit te prokurimit i publikuar ne platformen elektronike te e-prokurimit me daten 24.09.2020*

III

*Ky vendim hyn ne fuqi menjehere pas nenhkrimit te tij.*

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik “AlGroup” SH.P.K. nga Prishtina më datën 24.09.2020 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit i cili ndërlidhet me njoftimet për kontratë dhe dokumentet e tenderit të Autoritetit Kontraktues, me të cilin njoftim është shpallur tenderi me titull: “NDËRTIMI I ANEKSIT TË SHKOLLËS FILLORE NË MAMUSHË-FAZA E PARË NDËRTIMI I VRAZHDËT”.

Si autoritet kontraktues, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar e kemi shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim, duke u bazuar ne nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1 te rregullores për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim, pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave. Dhe pas shqyrtimit të pretendimeve në kërkesën për rishqyrtim, kemi ardhur në përfundim se O.E “AL GROUP” ka paraqitur pretendime të pa bazuara si më poshtë.

Citat: “Në dosje të tenderit FTD, pika 7.1 & 7.2 kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, kërkesa numër 7, ju keni kërkuar: O.E duhet të jenë të certifikuar me ISO 28841-2013.

Ne ju sjellim argumente qe kjo ISO 28841 2013 nuk është certifikate siç keni pretenduar ju, mirëpo është standard- manual se si duhet te punohet objekti me qellim qe te jete sa me i qëndrueshëm ndaj ndryshimeve sizmike apo intervenimet për rehabilitim te objektit ne rast te tërmetit.

Pra ne treg nuk ekziston ndonjë kompani e licencuar për certifikim te tille. Ketë standard mund ta gjeni dhe bleni ne forme te librit-manualit te cilit duhet përbajtur gjete punimeve te betonit. Ne bashkangjitur po ju dërgojmë linkun nga i cili mund te blihet ne forme elektronike ose hard copy.

Ne kërkojmë nga ju si AK te na konfirmoni se a e keni pasur fjalën qe kompania te jete e pajisur me një manual te tille nëse po, atëherë ne mund te paguajmë këtë manual ne mënyre elektronike për 119.79 Euro sepse certifikate për këtë nuk ka. Ne kemi hulumtuar dhe përgjigjen qe kemi marre po ju bashkëngjisim se bashku me këtë kërkesë ku na është thëne qe kjo nuk është certifikate mirëpo qëllimi i saj është te jap informacione te mjaftueshme për vlerësim sizmik. Nëse dini ju se ku jepet kjo licence, ju lutem na tregoni qe ta dimë edhe ne.”

Gjatë shqyrtimit të kërkesës së O.E. “AL GROUP” dhe pretendimit të tyre se për standardin ISO 28841-2013 nuk ka certifikatë, ne verifikuam dhe bëmë disa hulumtime në faqen zyrtare të Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim (International Organization for Standardization linku: <https://www.iso.org>) e cila njihet me shkurtesën ISO. Kjo është një organizatë e cila krijon standarde përfusha dhe lëmi të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin, sigurinë në punë, ambientin etj. dhe ndër standardet tjera ka krijuar edhe standardin ISO 28841-2013.

Duhet të kihet parasysh se Organizata Ndërkombëtare për Standardizim, vetëm krijon standardet nëpërmjet anëtarëve të saj, ajo bashkon ekspertë për të shkëmbyer njohuri dhe për të zhvilluar Standarde Ndërkombëtare përkatëse të tregut vullnetar, të bazuar në konsensus, të cilat mbështesin inovacionin dhe ofrojnë zgjidhje përfshirë globale, por nuk lëshon certifikata apo konfirmime që një Operator Ekonomik i plotëson këto standarde. Në faqen zyrtare të ISO shumë mirë shpjegohet se Certifikatat i lëshojnë organet e certifikimit (certification bodies). Organet e akredituar të certifikimit, janë operatorë të paanshëm të palëve të tre, të pavarur nga synimi i certifikimit dhe ata duhet të kenë kompetencën e specifikuar në standardet ndërkombëtare dhe parakushtet e tjera përfshirë operacionet e tyre. Organet e certifikimit të mbuluara nga akreditimi u ofrojnë klientëve të tyre certifikimin e sistemit të menaxhimit, certifikimin e produkteve dhe certifikimin e personelit.

Ndërsa udhëzuesi për vlerësimin e thjeshtuar sizmik dhe rehabilitimin e ndërtesave prej betoni për të cilin O.E. pretendon se këtë standard mund ta gjeni dhe bleni ne forme te librit-manualit te cilit duhet përbajtur gjatë punimeve te betonit, është një udhëzues për vlerësim por nuk është dëshmi se Operatori Ekonomik është i certifikuar me ISO.

Për të vërtetuar se një O.E. e plotëson standardin ISO 28841-2013 ai duhet të paraqet certifikatën apo konfirmimin prej njërit nga shumë organe te certifikimit (certification bodies) të cilat janë në tregjet vendore, evropiane dhe ndërkombëtare.

Ne nuk jemi kompetent që t'i sigurojmë operatorëve ekonomik informatat apo ti rekomandojmë se të cilët organe të certifikimit të bëjnë certifikim për standarde të caktuara, sikur ka kërkuar O.E. në kërkesën për rishqyrtim, por gjatë hulumtimit kemi hasur në së paku dy organe te certifikimit të cilat e bëjnë certifikimin e Operatorëve Ekonomik për plotësimin e standardit në fjalë e që në treg mund të janë edhe shumë të tjera.

Pra duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe dëshmitë dhe faktet e paraqitura nga O.E. konsiderojmë se pretendimet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim te parashtruar nga O.E asesi nuk janë të bazuara sepse për standardin ISO 28841-2013 ekzistojnë organe të certifikimit të akredituara për ti vlerësuar Operatorët Ekonomik se a e plotësojnë standardin në fjalë dhe nëse ata e plotësojnë këtë standard pajisen me certifikatë apo konfirmim për plotësimin e standardit.

### **Andaj**

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me 25.09.2020

Gazmend Gashi

Udhëheqësi i sektorit të prokurimit



Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë Organit Shqyrtaues të Prokurimit (OSHP) brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.